



**MiMi**

**Das Gesundheitsprojekt  
Mit Migranten für Migranten  
in Bayern**

albanisch



# Informata rreth koronës për Bavarinë

Informata në disa gjuhë  
Multilingual information

**Ethno-  
Medizinisches  
Zentrum e.V.**



Me përkrahje financiare nga:

Bayerisches Staatsministerium für  
Gesundheit und Pflege



Mbështetur nga:



## Përmbajtja

Rëndësia e informatave të besueshme në kohën e koronës.....	2
Virusi korona SARS-CoV-2 .....	3
Transmetimi dhe masat e mbrojtjes.....	4
Maskat dhe përdorimi i tyre .....	5
Shenja e një infektimi me virusin SARS-CoV-2 .....	5
Testimi për koronën .....	6
Mundësitë e testimit.....	7
Mundësitë e trajtimit .....	7
Vaksina mbrojtëse kundër sëmundjes COVID-19 .....	8
Vaksinimi përforcues kundër COVID-19 .....	10
Udhëzime për hyrjen në Republikën Federale të Gjermanisë .....	11
Burime të tjera informatash .....	12
Impressum (Indeksi) .....	13

## Rëndësia e informatave të besueshme në kohën e koronës

Pandemia e koronës ka ndryshuar jetën tonë të përditshme në mënyrë masive dhe ndikon në atë edhe në vazhdimësi. Për të mbrojtur vetveten, familjet tona dhe të gjithë bashkëqytetarët tanë / të gjitha bashkëqytetarët tona na nevojiten informata të besueshme dhe të kuptueshme rreth shëndetit.

Situata e pandemisë ngaherë ndryshon. Autoritetet kompetente, institucionet shkencore, shërbimi shëndetësor, mediat dhe politika përpiqen t'i informojnë njerëzit. Megjithatë mund të jetë e vështirë t'i gjeshtë të gjitha këto informata, që të nevojiten në çast. Në situata të tilla, njerëzit

janë të pasigurt dhe përpiqen të marrin informata të mëtejshme në rrugë të ndryshme. Për fatkeq ata përballin shpesh, edhe në mediat sociale, me informata të rrema, të cilat pastaj i fusin në pasiguri.

Veç kësaj, jo të gjitha informatat ekzistojnë në të gjitha gjuhët e nevojshme. Prandaj këtu ne i kemi përmbledhur informatat më të rëndësishme thelbësore për njerëz me prapaskenë migrimi në Bavari. Për informata më të reja dhe për detaje të tjera, në tekstin vijues të informimit kemi futur adresa interneti me burime të besueshme.

## Virusi korona SARS-CoV-2

SARS-CoV-2 është një virus i ri i llojit korona, i cili në fillim të vitit 2020 u identifikua si shkaktuesi i sëmundjes COVID-19 dhe që nga atëherë është përhapur në mbarë botën. Viruse të ngjashme korona tashme në kaluarën kanë shkaktuar sëmundje të rënda të rrugëve të frymëmarrjes të njeriut, të cilat përhapen shpejt (SARS/Sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes dhe MERS/Sindroma e frymëmarrjes në lindjen e mesme). Sipas njohurive shkencore dyshohet, që këto viruse në ndonjë moment kanë kaluar nga kafshe të egra – nga “bujtësit” e tyre të deriatëhershme – te njerëzit.

Aq më intensive është situata e infektiveve dhe kështu përhapja e viruseve, sa më shpesh gjatë shumëzimit të tyre ndodhin ndryshime në ADN-në e tyre, gjë që çon te variante të reja. Në rastin e virusit SARS-CoV-2, këto variante emërtohen me germa greke.

Posaçërisht të moshuar dhe njerëz me sëmundje të mëparshme kanë një rrezik të shtuar për një zhvillim të rëndë të sëmundjes, por edhe te persona të rinj mund të zhvillohen pneumoni me probleme frymëmarrjeje, të cilat duhet të trajtohen në spital. Një pjesë e këtyre pacientëve/pacienteve vdes prej sëmundjes COVID-19 me gjithë trajtimin e mjekësisë intensive. Ky fakt është tragjik jo vetëm për të cenuarit dhe të afërmit e tyre, sepse: Aq më intensiv të përhapet virusi, aq më shumë do të rëndohet sistemi shëndetësor ose në rastin më të keq ai do të mbingarkohet: edhe pacientë të tjerë/pacientë të tjera pastaj nuk mund të marrin shërbimin optimal. Masa të ndryshme – nga obligimi i mbajtjes së maskës nëpër vaksinimit deri në mbylljen e jetës publike (“Lockdown”) – janë synuar ta parandalojnë këtë situatë.

Pavarësisht nga grada e saj, një sëmundje COVID-19 mund ketë edhe pasoja të mëvonshme ose afatgjata (të cilat njihen nën emrin Long-COVID resp. Post-COVID): p.sh. çrregullime organesh, ndjenje e përgjithshme dobësie, plogështi, errësime kujtese ose lodhje e vazhdueshme. Disa të cenuar mund ta përballojnë jetën e tyre të përditshme vetëm me mundim apo nuk e përballojnë dot më.

Nëse vuani nga kufizime shëndetësore akoma edhe shumë kohë pas infektimit tuaj, drejtohuni mjekes suaj ose mjekut tuaj familjar. Ka gjithmonë e më shumë oferta për persona me Long- resp. Post-COVID. Më shumë informata gjeni për shembull në këto faqe interneti:

<https://www.infektionsschutz.de/coronavirus/basisinformationen/long-covid-langzeitfolgen-von-covid-19/#c16099>

<https://www.stmgp.bayern.de/coronavirus/post-covid/>

Më shumë informata mbi prapaskenën dhe informata aktuale gjinden në shumë gjuhë në këto faqe interneti:

[integrationsbeauftragte.bayern.de/downloads/](https://integrationsbeauftragte.bayern.de/downloads/)

[mimi.bayern/index.php/muenchen-corona-alltag](https://mimi.bayern/index.php/muenchen-corona-alltag)

[integrationsbeauftragte.de/ib-de/staatsministerin/corona](https://integrationsbeauftragte.de/ib-de/staatsministerin/corona)

[zusammengengencorona.de](https://zusammengengencorona.de)

## Transmetimi dhe masat e mbrojtjes

Virusi SARS-CoV-2 transmetohet gjatë lëshimit të frymës (posaçërisht në të folur dhe të kënduar) përmes aerosolëve dhe pikëzave të krijuara (p.sh. gjatë teshtitjes dhe kollitjes). Nga që aerosolët për disa orë mund të mbeten infektivë, virusi nëpërmjet frymëmarrjes mund t'u ngjitet personave të tjerë përmes këtyre aerosolëve infektivë. Viruset edhe mund të transmetohen nga sipërfaqet përmes duarve në fytyrë.

Rregullat e përgjithshme të higjienës (**distancë – higjienë – maskë + ajrosje + aplikacion në celular**) kanë si synim t'i ndërpresin këto rrugë transmetimi:

**Distancë:** Mundësitë e transmetimit zvogëlohen dukshëm, nëse njerëzit mbajnë një distancë prej të paktën 1.5 metrave nga persona të tjerë.

**Higjienë:** Larja e herëpashershme e duarve me përpikëri me sapun i asgjëson viruset në lëkurë.

**Maskë në jetën e përditshme:** Mbulimi korrekt i gojës dhe i hundës me një maskë mjekësore për fytyrën/maskë për gjysmë fytyre me filtrim copëzash pa ventil parandalon hyrjen dhe daljen e aerosolëve dhe të pikëzave gjatë frymëmarrjes – shih *Maskat dhe përdorimi i tyre*.

**Ajrosje:** Ajrosja e herëpashershme e dhomave të mbyllura zvogëlon përqendrimin e aerosolëve dhe të pikëzave infektive brenda tyre.

**Aplikacion në celular:** Përdorimi i aplikacionit të paralajmërimit të koronës për celularë "Smartfona" i ndihmon njerëzit ta ndërpresin zinxhirët e infektimit. Ai jepet falas në dyqanet "App Store" dhe "Google Play".

Si shtesë për këto rregulla baze, në Landet e Federatës vlejné masa të tjera.

Rregullat aktuale të Urdhëresës mbi masat e mbrojtjes nga infektimi në Bavari i gjeni në disa gjuhë në [stmgp.bayern.de/coronavirus/rechtsgrundlagen](https://stmgp.bayern.de/coronavirus/rechtsgrundlagen)

## Maskat dhe përdorimi i tyre

Mbulimi korrekt i gojës dhe i hundës me maska mjekësore për fytyrën/maskë për gjysmë fytyre me filtrim copëzash pa ventil mbron nga transmetimi i virusit korona përmes aerosolëve dhe pikëzave. Në varësi të rregullave aktuale, në shumë ambiente publike ekziston një obligim për mbajtjen e maskës. Maskat e përditshme prej stofi nuk rekomandohen më fare, dhe ndërkohe lejohen vetëm maska të caktuara.

**Maska mjekësore fytyre ("maska operimi"):** Këto maska kryesisht e mbrojnë personin përballë nga pikëzat infektive të mbajtësit/mbajtëses së maskës. Nëse mbahen të lidhur ngushtë në fytyrë, ato ofrojnë një mbrojtje të kufizuar për personin mbajtës. Këto maska mjekësore fytyre janë produkte njëpërdorimshme dhe i përmbushin parakushtet ligjore, nëse e mbajnë shenjën CE. Në momentin, që ato lagen, ato e humbin efektin mbrojtës dhe duhet të zëvendësohen.

**Gjysmë-maskë me filtrim partikujsh (maska të standardeve FFP2, FFP3 dhe KN95/N95):** Këto maska mbrojnë nga partikujt, pikëzat si dhe nga aerosolët. Ato ekzistojnë me dhe pa ventil. Pa ventil ato mbrojnë, nëse mbahen në mënyrë



korrekte (të lidhur ngushtë në fytyrë), edhe mbajtësit/mbajtëset si edhe persona përreth. Ventili e lë ajrin të dalë pa asnjë pengesë. Një maskë me ventil atëherë e mbron vetëm personin, që e mban, por vë të tjerët në rrezik: Prandaj mbajtësit e maskave të tilla nuk i përmbushin kërkesat e obligimit ligjor të mbajtjes së maskës.

Të gjitha maskat duhet të mbahen të lidhur ngushtë në fytyrë. Ato duhet të mbulojnë hundën dhe gojën, me qëllim që ato të mund të japin mbrojtjen përkatëse. Nëse përdorimi i maskave për shkak të problemeve shëndetësore ju duket gjë e rëndë, konsultohuni me një mjek.

## Shenja e një infektimi me virusin SARS-CoV-2

Nga ngjitja deri në shfaqjen e shenjave të sëmundjes mesatarisht kalojnë në rastin e variantit momentalisht zotues Omikron tri ditë. Maksimalisht janë deri në 14 ditë. Por persona të infektuar tashme mund t'ia ngjitin sëmundjen të tjerëve para se të vihen re shenjat e sëmundjes. Jo të gjithë njerëzit, që infektohen me virusin SARS-CoV-2, sëmurën.

Simptoma më të shpeshta janë kollë, rrufë, temperaturë si dhe humbje nuhatjeje dhe shijimi. Të mundshme janë gjithashtu dhimbje koke dhe gjymtyre, plogështi, dhimbje fyti, dhimbje barku, të përzier, të vjella dhe diarre.

Nëse vini re simptoma të sëmundjes COVID-19 te vetja ose nëse keni pasur kontakte me një person të infektuar, shmanguni kontakteve me njerëz të tjerë dhe qëndroni në shtëpi (karantinë). Ju lutemi të mos shkoni në një ambulancë mjekësore pa pajtim të mëparshëm termini. Telefononi ambulancën e mjekut tuaj familjar ose shërbimin e gatshëm mjekësor. Ai mund të thirret në gjithë Gjermaninë në çdo kohë nën numrin 116 117. Në raste emergjente thirreni numrin 112.

## Testimi për koronën

Ka metoda të ndryshme për të konstatuar, nëse një person është infektuar me virusin SARS-CoV-2. Në këtë shpjegim prezantohen dy metoda, që përdoren shpesh.

Në **testimin e shpejt për antigjene** analizohet, nëse gjinden përbërës të caktuar (proteina) të virusit në trup. Për këtë test merret me një shklopt një provë nga mukoza në zgavrën e hundës dhe materiali pastaj analizohet për antigenin e virusit SARS-CoV-2. Testime për antigjene bëhen shpejt dhe janë të mundur edhe pa laborator, megjithatë rezultati i tyre nuk është njëqind për qind i sigurt.

Veç kësaj gjëje ekzistojnë edhe ndryshime në cilësi të testeve në varësi të prodhuesit. Instituti "Paul Ehrlich" aktualizon rregullisht listën e tij të testeve për antigjene ([https://www.pei.de/DE/newsroom/dossier/coronavirus/coronavirus-inhalt.html;jsessionid=588CBB6CF0B0E096A1D596D1788FA8AC.intranet231?nn=169730&cms\\_pos=8](https://www.pei.de/DE/newsroom/dossier/coronavirus/coronavirus-inhalt.html;jsessionid=588CBB6CF0B0E096A1D596D1788FA8AC.intranet231?nn=169730&cms_pos=8)).

Sa më e lartë (maksimumi 100 %) është vlera Cq e vlerësuar atje, aq më i mirë është testimi. Vlera Cq atje duhet të jetë  $\leq 25$  100 % dhe vlera Cq 25 – 30 të jetë sa më e lartë.

Një rezultat negativ vërteton vetëm, që personi në momentin e testimit me shumë gjasa nuk është infektiv, pra që në orët vijuese ekziston vetëm një rrezik i vogël t'ia ngjitesh sëmundjen dikujt tjetër. Sado rreziku nuk është zero. Edhe mund të jetë, që personi tashme është infektuar, por nuk prodhon mjaft viruse për vërtetimin përmes testimit të shpejtë. Ose, që personi tashme e ka kaluar infeksionin. Prandaj masat e mbrojtjes (rregullat distancë – higjienë – maskë + ajrosje + aplikacion



në celular) duhet të zbatohen medoemos në vazhdimësi edhe me një rezultat negativ në një testim për antigjene. Nëse një rezultat testimi për antigjene është "pozitiv", atëherë nevojitet një vërtetim me një testim PCR.

**Testimi PCR (Polymerase Chain Reaction/reagim për zinxhirin e polimerazës)** tregon, nëse ekziston ADN-ja e virusit. Ai është më shumë domethënës dhe i besueshëm sesa testimi për antigjene dhe prandaj përdoret si testim verifikues. Në testimin PCR – siç edhe në testimin e shpejtë – merret një provë në hundë ose fyt dhe pastaj analizohet në laborator. Duhet normalisht një deri dy ditë, derisa del rezultati. Ky testim është jashtëzakonisht i besueshëm dhe ka standardin më të lartë.

**Me rëndësi për të ditur:** Një rezultat pozitiv në një testim në përgjithësi nuk do të thotë, që dikush e mban fajin për infektimin: Masa mbrojtëse vërtet mund të kufizojnë përhapjen e virusit dhe mund të zvogëlojnë rrezikun e infektimit, por nuk mund ta përjashtojnë atë plotësisht.

## Mundësitë e testimit

Të gjithë qytetarët/të gjitha qytetaret mund të marrin të paktën një testim të shpejtë antigjenesh falas në javë. Testime ka ndër të tjera në qendra testimi dhe në farmaci. Testimi kryhet nga personeli i shkolluar. Ky lëshon një vërtetim të printuar ose digjital për rezultatin. Një rezultat negativ testimi për antigjene mbetet i vlefshëm për maksimalisht 24 orë dhe vetëm për qëllime të caktuara zyrtare.

Testime të shpejta për antigjene ka edhe si testime për vetveten në farmaci, dyqane për detergjente dhe në tregun e pakicës. Sado rezultati i testimit për vetveten në shumicën e rasteve nuk njihet për qëllime zyrtare. Prapëseprapë testime për vetveten mund të ofrojnë një siguri të shtuar për vizita, nëse të gjithë pjesëmarrës pak përpara e testojnë vetveten.

Për të parandaluar infektive në vendin e punës, punëdhënës/punëdhënëse duhet të caktojë masat për mbrojtjen kundër infektiveve brenda kompanisë. Masat bazë janë ndër të tjera zbatimi i distancës minimale, ajrosja e ambienteve të brendshme, mbajtja e maskave dhe oferta të rregullta testimesh (testime të shpejta ose testime për vetveten) për punëmarrësit/punëmarrëset, të cilët nuk punojnë vetëm në shtëpi. Vendimin, se cilat masa janë të nevojshme dhe zbatohen në kompaninë përkatëse, e marrin punëdhënësit/punëdhënëset.

Në testime të shpejta për antigjene dhe në testime për vetveten, përqindja e rezultateve të gabuara është e shtuar. Prandaj rekomandohet, që pas një rezultati pozitiv në një testim të shpejtë për antigjene ose në një testim për vetveten të kryhej një testim PCR.

## Mundësitë e trajtimit

Për persona, të cilët kanë një rrezik të lartë për një zhvillim të rëndë COVID-19, në Gjermani tashme janë në dispozicion disa medikamente për terapinë e hershme të COVID-19, të cilat mund/duhet të pengojnë shumëfishimin e virusit në trup: të ashtuquajturit antitrupa monoklonalë, të

Testime PCR kryhen nga personeli i specializuar ndër të tjera në ambulanca mjekësore dhe në qendra testimi. Edhe këtu merret një vërtetim i printuar ose digjital për rezultatin, i cili është i vlefshëm për qëllime zyrtare.

Të gjitha rezultatet pozitive të testimeve (përveç testimit për vetveten) i njoftohen gjithashtu entit kompetent të shëndetësisë, me qëllim që ai të caktojë masat e nevojshme të mbrojtjes nga infektimi. Për t'i mbrojtur të tjerët ka rëndësi, që një rezultat pozitiv të regjistrohet në aplikacionin e paralajmërimit për koronën në celularin e vet smartfon. Pastaj personat, me të cilët keni qëndruar afër, marrin një rekomandim testimi.

Për të gjithë persona, të cilët marrin një rezultat pozitiv në një testim për vetveten për virusin e koronës, vlen: Bëni mirë të izoloni veten menjëherë dhe t'u shmangeni kontakteve me njerëz të tjerë aq, sa është e mundur, sepse ekziston dyshimi, që ju jeni shumë infektiv. Nëse testimin nuk e keni kryer në shtëpi, atëherë shkoni në rrugën e drejtpërdrejte në banesën tuaj. Kujdeseni edhe për rregullat e distancës dhe të higjienës. Pajtohuni menjëherë për një termin përmes mjekes suaj familjare ose mjekut tuaj familjar, përmes shërbimit të gatshëm të bashkimit të mjekëve të sigurimit të shëndetësisë nën numrin 116 117 ose përmes entit të shëndetësisë për një testim PCR për ta verifikuar rezultatin e testimit për vetveten. Atje ju merrni gjithashtu të gjitha informatat për veprimin e mëtejshëm.

cilat jepen në ambulanca mjekësore ose spitale si infuzion ose gjilpërë, dhe terapi antivirale kundër COVID-19 për pirjen orale në shtëpi. Këtu duhet vënë re, që fillimi i terapisë duhet të jetë sa më parë pas diagnozës dhe në shumicën e rasteve vetëm brenda 5 ditëve të para pas fillimit të simptomave.

## Vaksina mbrojtëse kundër sëmundjes COVID-19 (imunizimi bazë)

Kufizime në jetën publike dhe private si kufizime kontaktesh dhe mbyllja e jetës publike ("Lockdown") janë masa afatshkurtra. Ato shërbejnë të kufizohet përhapja e virusit, të mbrohet sistemi shëndetësor nga mbingarkesa dhe t'u shmangen rasteve të vdekjes. Sado qëllimi afatgjatë është, që virusi SARS-CoV-2 të mos përhapet më pa kontroll dhe që sëmundja COVID-19 të mos ketë më pasoja të rënda. Ky qëllim mund të arrihet me vaksina mbrojtëse.

Lëndët e vaksinimit të shpikura deri tani kundër sëmundjes COVID-19 kanë si synim të parandalojnë zhvillime të rënda dhe vdekjeprurëse të sëmundjes. Ato zvogëlojnë edhe gjasën, që të infektohen persona të tjerë, por nuk e parandalojnë këtë gjë me siguri. Në Gjermani tashme janë lejuar pesë lëndë vaksinimi kundër sëmundjes COVID-19, të cilat janë bërë të njohura me emrat e prodhuesve të tyre:

- Comirnaty® (BioNTech/Pfizer, imunizimi bazë: dy doza vaksinimi në distancën prej 3 deri 6 javësh, që nga mosha 12-vjeçare; për fëmijë që nga mosha 5-vjeçare me sëmundje të tjera resp. me kontakte me persona të rrezikuar ose në rast dëshire dhe pas udhëzimit mjekësor, dy doza vaksinimi të formulës së përshtatshme për moshën në distancë prej 3 deri 6 javësh; për të gjithë fëmijët e shëndetshëm midis moshës 5-dhe 11-vjeçare një dozë vaksinimi e formulës së përshtatshme për moshën)
- Spikevax® (Moderna, imunizimi bazë: dy doza vaksinimi në distancën prej 4 deri 6 javësh, rekomanduar nga mosha 30 vjeçare)
- Vaxzevria® (AstraZeneca, dy doza vaksinimi në distancën prej 4 deri 12 javësh, rekomanduar që nga mosha 60-vjeçare; megjithatë për dozën e dytë të vaksinimit rekomandohet aktualisht një lëndë vaksinimi mRNA në vend të vaksinës Vaxzevria®)



- Jcovden® (Johnson&Johnson, një dozë vaksinimi, rekomanduar që nga mosha 60-vjeçare; personave, të cilët u vaksinuan një herë me Jcovden, për arritjen e imunizimit bazë duhet të kenë një vaksinë tjetër. Për këtë rekomandohet një prej lëndëve të vaksinimit mRNA duke filluar 4 javë pas vaksinimit të fundit)
- Nuvaxovid® e kompanisë farmaceutike Novavax nga SHBA-ja (imunizimi bazë: dy doza vaksinimi në distancën prej të paktën 3 javësh; rekomandohet që nga mosha 18-vjeçare, jo për gra shtatzëna dhe gji-dhënëse) Kjo vaksinë ka aktualisht vetëm një licencë për imunizimet bazë, jo për vaksinime rifreskuese ("Booster").

Comirnaty® (BioNTech/Pfizer) dhe Spikevax® (Moderna) janë **lëndë vaksinimi mRNA**. Lënda e vaksinimit nuk transporton asnjë virus, por planin e ndërtimit (mRNA) për një përbërës të mbështjellëses së tij (proteina „Spike“) në qelizat e trupit. Këto pastaj e prodhojnë për një kohë të shkurtër proteinën „Spike“. Sistemi ynë i imunitetit e dallon atë si të huaj dhe për mbrojtjen formon antitropa dhe qeliza imuniteti. Nëse personi i vaksinuar pastaj hyn në kontakt me virusin real SARS-CoV-2-Virus, sistemi i imunitetit e rinjeh proteinën „Spike“ në sipërfaqen e tij dhe mund ta luftojë virusin menjëherë me antitropat tashme ekzistues dhe gjithashtu mund të riprodhojë shpejt sasi të mëdha antitropash. Kështu nuk ka shumë gjasa për një infektim me një zhvillim të rëndë të sëmundjes.

Fleta udhëzuese për vaksinën COVID-19 (lënda e vaksinimit mRNA) në më shumë se 20 gjuhë: [rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.html](https://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.html)



Lënda e vaksinimit nga Novavax (Nuvaxovid®) përkundrazi përmban proteina "Spike" të gatshme të prodhuara në laborator, të cilat jepen së bashku me një përforcues efekti si gjilpërë. Këto proteina njihen nga sistemi i imunitetit në vendin e vaksinimit, dhe formimi i antitropave nxitet. Sipas këtij parimi funksionojnë edhe shumë lëndë vaksinimi kundër gripit, të cilat tashme kanë shumë vite që përdoren.

Fleta udhëzuese për vaksinën COVID-19 (lënda e vaksinimit në bazë të proteinave) në më shumë se 20 gjuhë:

[www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Proteinimpfstoff-Tab.html](http://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Proteinimpfstoff-Tab.html)

Lëndët e vaksinimit Vaxzevria® prej firmës AstraZeneca dhe Covid-19 Vaccine Jcovden® prej firmës Johnson&Johnson janë **lëndë vaksinimi "Vektor"**. As ato nuk transportojnë në trup viruse korona, por ADN-në për proteinën "Spike". Zhvilluesit e këtyre lëndëve të vaksinimit shfrytëzojnë si mjet transporti (vektor) një virus të padëmshëm për njeriun, i cili nuk mund të shumëzohet më. Edhe këtu qelizat tona trupore e prodhojnë pastaj për një kohë të shkurtër proteinën "Spike". Sistemi i imunitetit pastaj i mban në gatishmëri antitropa të përshtatshme si lëndë mbrojtëse kundër virusit SARS-CoV-2.

Fleta udhëzuese për vaksinën COVID-19 (lënda e vaksinimit "Vektor") në më shumë se 20 gjuhë:

[rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Vektorimpfstoff-Tab.html](http://rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Vektorimpfstoff-Tab.html)

**Me rëndësi:** Lënda e vaksinimit në bazë të proteinave nga Novavax njësoj si lëndët e vaksinimit mRNA dhe "Vektor" nuk përmban pjesë të virusit SARS-CoV-2, të cilat mund të shumëfishohen. Kësisoj edhe në këtë lëndë të re vaksinimi kundër COVID-19 bëhet fjalë për një lëndë vaksinimi pa viruse të gjalla.

Në Gjermani Instituti "Paul Ehrlich" (PEI) shqyrton vazhdimisht sigurinë, efektshmërinë dhe afatin e mbrojtjes të lëndëve të shfrytëzuara të vaksinimit. Komisioni i përhershëm i vaksinimit (STIKO) i Institutit "Robert Koch" (RKI) lëshon rekomandimet e vaksinimit për Gjermaninë, të cilat aktualizohen vazhdimisht dhe përdoren si standard nga sistemi i këtushëm shëndetësor.

Si në të gjitha vaksinimet e tjera, reagime ndaj vaksinimit dhe efekte anësore janë të mundshme. Shqetësime dalin shpesh brenda orësh dhe ditësh. Ato rrallë zgjasin më shumë se tri ditë. Reagimi më i shpeshtë janë dhimbjet në vendin e shpimit. Të tjera janë plogështi, dhimbje koke, ethe dhe temperaturë. Nëse shqetësimet zgjasin më shumë se tri ditë, është mirë të konsultoni një mjek. Shqetësime të rënda si reagime alergjike, paraliza fytyre dhe tromboza ose çrregullime mpiksjeje janë shumë të rralla.

Arsyeja për rekomandimin e moshës "që nga 60 vjeç" në lëndët e vaksinimit prej firmave AstraZeneca dhe Johnson&Johnson janë efekte anësore shumë të rralla por të rënda (tromboza në venet e trurit) tek të vaksinuar nën moshën 60 vjeçare. Të rritur nën 60 vjeç mund të sqarohen gjerësisht nga mjekët/mjeket e tyre për këtë rrezik dhe, nëse e pranojnë këtë rrezik individual dhe bien shprehimisht dakord, ata megjithatë mund të vaksinohen me këto lëndë vaksinimi.

## Vaksinimi përforcues kundër COVID-19

STIKO-ja [Komisioni i përhershëm i vaksinimit] u rekomandon të gjithë personave që nga moshën 12-vjeçare një vaksinim përforcues kundër COVID-it, duke filluar 3 muaj të plotë pas përfundimit të imunizimit bazë.

Vaksinimi përforcues duhet të kryhet me një lëndë vaksinimi mRNA. Për të gjithë personat nën moshën 30-vjeçare dhe për gratë shtatzëna duhet të përdoret këtu vetëm Comirnaty® si lëndë vaksinimi.

Për personat që nga moshën 30-vjeçare dhe sipër të dyja lëndët e vaksinimit mRNA (Comirnaty® dhe Spikevax®) shikohen aktualisht si të përshtatshme për vaksinimin përforcues.

Rekomandimi për vaksinimin përforcues kundër COVID-19 vlen edhe për gratë shtatzëna duke filluar nga javën e 13 të shtatzënisë dhe për persona mbi moshën 12-vjeçare, të cilat tashmë kishin një infektim me SARS-CoV-2 dhe më pas kanë marrë një dozë vaksinimi.

Një **vaksinim i dytë rifreskimi** rekomandohet për persona me shëndet posaçërsisht të rrezikuar (njerëz mbi moshën 70 vjeçare, banues/e dhe persona nën kujdestari në institucionet e përkujdesjes, njerëz me dobësi imuniteti që nga moshën 5-vjeçare) si dhe për personelin në institucionet e përkujdesjes dhe të shëndetësisë.

Tek njerëzit e tillë me shëndet posaçërsisht të rrezikuar rekomandohet vaksinimi i dytë rifreskues jo më herët se 3 muaj pas vaksinimit të parë rifreskues.

Rekomandohet që personeli i institucioneve shëndetësore dhe të përkujdesjes ta marrë vaksinimin e dytë rifreskues jo më herët se 6 muaj pas vaksinimit të parë rifreskues.

Për personat, të cilët kanë marrë imunizimin bazë me një lëndë vaksinimi jo të lejuar brenda BE-së (p.sh. CoronaVac nga Sinovac, Covilo nga Sinopharm, Covaxin nga Bharat Biotech International Ltd. ose Sputnik V nga Gamaleja) ose kanë marrë tashmë një vaksinim rifreskues, rekomandohet si shtesë një vaksinim me një lëndë vaksinimi mRNA (një vaksinim me një distancë prej të paktën 3 muajsh pas vaksinimit të fundit) për një mbrojtje më të mirë. Nëse pas imunizimit bazë të ketë ndodhur një infektim, vaksinimi bëhet jo më parë se pas 3 muajsh.

Për atë person, që është vaksinuar vetëm një herë me një lëndë vaksinimi të palejuar, rekomandohet marrja e një serie komplete vaksinimi me një lëndë vaksinimi të lejuar këtu, përfshirë rifreskimin.

## Udhëzime për hyrjen në Republikën Federale të Gjermanisë

Për udhëtarët, që hyjnë në Gjermani, vlejné rregullat, të cilat orientohen në rrezikun e zonës së origjinës.

Zona të ndryshme mund të kategorizohen si zona të varianteve të virusit. Në këtë rast vazhdojnë të vlejné rregulla të rrepta regjistrimi, vërtetimi dhe karantinimi dhe edhe në mënyrë afatshkurtër mund të caktohen ndalesa për hyrjen në Gjermani. Se cilat shtete resp. rajone kategorizohen si zona të varianteve të virusit, kjo mund të gjindet në faqen e internetit të RKI-së, e cila aktualizohet rregullisht: [rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges\\_Coronavirus/Risikogebiete\\_neu.html](https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Risikogebiete_neu.html)

Që nga data 31/05/2022 nuk vlen më një obligim i përgjithshëm vërtetimi gjatë hyrjes në Gjermani.

Nëse një person ka qendruar më parë në një zonë të varianteve të virusit dhe hyn në Gjermani, atëherë duhet të parashtrohet një rezultat negativ të testit PCR, një vërtetim vaksinimi ose shërimi nuk mjafton në këtë rast. Një testim për antgjene nuk mjafton. Testi PCR nuk lejohet të jetë më i vjetër se 48 orë.

Ai person, që hyn pas një qëndrimi në një zonë të huaj të varianteve të virusit, si shtesë duhet të respektojë një obligim karantinimi, shih më poshtë për më shumë detaje.

Nëse hyrja kryhet nga një zonë me variante virusi, atëherë vërtetimi i testimit PCR negativ, i vaksinimit ose i shërimit kërkohet gjatë kontrollit të trafikut të kalimit kufitar për në Gjermani nga ana e Policisë Federale ose nga ana e autoritetit kompetent. Vërtetimet kontrollohen rastësisht.

Në rastin e një qëndrimi në një zonë të varianteve të virusit brenda dhjetë ditëve të fundit, para hyrjes në Gjermani duhet të kryhet regjistrimi digjital i hyrjes (DEA). Ky regjistrim hyrjeje është një formular elektronik, që duhet të përmbushet në internet: [einreiseanmeldung.de/#/](https://einreiseanmeldung.de/#/)

Veç kësaj pas një qëndrimi në një zonë të varianteve të virusit parimisht ekziston një **obligim karantinimi**. Obligim karantinimi do të thotë, që ju pas hyrjes në Gjermani duhet ta izoloni vetveten në shtëpi parimisht për 14 ditë. Në disa raste, afati i karantinimit shkurtohet. Në rrethana të caktuara ka përjashtime nga obligimi i karantinimit. Ministria Federale e Shëndetësisë informon për këtë gjë në: <https://www.bundesgesundheitsministerium.de/service/gesetze-und-verordnungen/guv-19-lp/coronaeinreisev.html>

Nëse dyshoni, që mund të jeni infektuar me virusin korona (shih Shenja e një infektimi me virusin SARS-CoV-2), atëherë testohuni menjëherë (shih Testimi për koronën).

## Burime të tjera informatash

### për gjithë Bavarinë:

Bayerisches Staatsministerium für Gesundheit und Pflege  
[stmgp.bayern.de/coronavirus](https://stmgp.bayern.de/coronavirus)

Bayerisches Landesamt für Gesundheit und Lebensmittelsicherheit  
[lgl.bayern.de/gesundheits/infektionsschutz/infektionskrankheiten\\_a\\_z/coronavirus/faq.htm](https://lgl.bayern.de/gesundheits/infektionsschutz/infektionskrankheiten_a_z/coronavirus/faq.htm)

Bayerisches Staatsministerium des Innern  
– Katastrophenschutz (Mbrotja në raste katastrofash)  
[corona-katastrophenschutz.bayern.de](https://corona-katastrophenschutz.bayern.de)

Kassenärztliche Vereinigung Bayern –  
Arztliche Suche für Test (Kërkimi i mjekut për testimin)  
<https://dienste.kvb.de/arztliche/suche/app/suchergebnisse.htm?hashwert=a126d5d04b692b87be6ccbe3b2717826&lat=48.1351253&lng=11.5819805&zeigeKarte=true>

Integrationsbeauftragte der  
Bayerischen Staatsregierung – Informata në disa gjuhë  
[integrationsbeauftragte.bayern.de/downloads](https://integrationsbeauftragte.bayern.de/downloads)

### për gjithë Federatën:

Robert Koch-Institut (RKI) – Pandemia aktuale  
[rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.html](https://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.html)

Robert Koch-Institut (RKI) – Informata mbi vaksinimin për lëndë vaksinimi mRNA në më shumë se 20 gjuhë  
[rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.html](https://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Aufklaerungsbogen-Tab.html)

Robert Koch-Institut (RKI) –  
Informata mbi vaksinimin për lëndë vaksinimi “Vektor” në më shumë se 20 gjuhë  
[rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Vektorimpfstoff-Tab.html](https://www.rki.de/DE/Content/Infekt/Impfen/Materialien/COVID-19-Vektorimpfstoff-Tab.html)

Das Auswärtige Amt – Siguria e udhëtarëve  
[auswaertiges-amt.de/de/ReiseUndSicherheit](https://www.auswaertiges-amt.de/de/ReiseUndSicherheit)

Bundesministerium für Gesundheit –  
Regjistrimi i hyrjes në Gjermani  
[einreiseanmeldung.de/#/](https://www.bmi.bund.de/SharedDocs/Service/DE/Service/einreiseanmeldung.de/#/)

Bundesministerium für Gesundheit –  
Zusammen gegen Corona  
(Së bashku kundër koronës)  
[zusammengegencorona.de](https://www.zusammengegencorona.de)

Integrationsbeauftragte der Bundesregierung –  
Informata në disa gjuhë  
[integrationsbeauftragte.de/ib-de/staatsministerin/corona/coronavirus-wir-informieren-in-mehreren-sprachen-deutsch--1874222](https://integrationsbeauftragte.de/ib-de/staatsministerin/corona/coronavirus-wir-informieren-in-mehreren-sprachen-deutsch--1874222)

BZgA – Informata në disa gjuhë  
[infektionsschutz.de/mediathek/printmaterialien/printmaterialien-zum-coronavirus.html](https://www.infektionsschutz.de/mediathek/printmaterialien/printmaterialien-zum-coronavirus.html)

Ethno-Medizinisches Zentrum e.V. –  
COVID Alliance Multi-Lingual-Info  
[corona-ethnomed.sprachwahl.info-data.info](https://corona-ethnomed.sprachwahl.info-data.info)

## Impressum/Legal Notice

### Herausgeber:

MiMi Zentrum für Integration in Bayern  
Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.  
Zenettiplatz 1 – 80337 München  
E-Mail: bayern@mimi.eu – mimi.bayern

### Gefördert durch:

Bayerisches Staatsministerium  
für Gesundheit und Pflege  
Haidenauplatz 1 – 81667 München  
Gewerbemuseumsplatz 2 – 90403 Nürnberg  
stmgp.bayern.de

### Unterstützt durch:

MSD Sharp & Dohme GmbH  
Levelingstraße 4a – 81673 München

**Presseanfragen:** bayern@mimi.eu

© 2021 Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.

**Stand:** 15.06.2022 | Version 003

**Layout:** eindruck.net, Hannover

**Sprachen:** Verfügbar in verschiedenen Sprachen

**Übersetzungen:** Dolmetscherdienst –  
Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.

**Abbildungen:** iStock.com

### Quellen:

Bayerisches Staatsministerium für  
Gesundheit und Pflege, LGL, BMG, RKI, BZgA, KVB,  
StMUK, StMI, StMAS, EMZ-COVID Alliance

### URL-Verweise:

Für Inhalte externer Seiten, auf die hier verwiesen  
wird, ist der jeweilige Anbieter verantwortlich.

### Datenschutzerklärung

V.i.S.d.P.: Ethno-Medizinisches Zentrum e.V.